


-S.T.I.M.P
20.06.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
KORÇE

Korçë, me 24.06.2022

SHPLLJE VENDIMI

Drejtuar : Bashkise Maliq

Per: shtetasen : Jurilda Jorgo Stefo(Çela), me adrese Maliq.

Bashkalidhur po ju dergojme shpalljen per vendimin civil nr. 182, date 07.03.2022 per t'u afishuar nga ana Juaj njoftimi me shpallje me afat 20 ditor, pasi deftesa e komunikimit eshte kthyer me shenimin : " Larguar ... " dhe pas afishimit kjo shpallje te na kthehet e konfirmuar me vule e firme, ne gjykate.

KANCELARE
Lubiana KINOLLI



U afishua sot ne date -----
Bashkia Maliq

Nenpunesi _____
(emer, mbiemer, firme)

Mr. 73 Prot
Dt. 30.06.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË

Nr. 21001-02255-41-2022 (637/1552) Regj.
Datë regjistrimi 14.12.2021

Nr. 41-2022-679 (182) VENDIMI
Datë Vendimi 07.03.2022

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, e përbërë prej:

Gjyqtare LULJETA KOLE

Asistuar nga sekretare Janulla Tanka, në Korçë, në datë 07.03.2022, ora 11.00, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen civile që i përket:

PADITËSE: Kristo Stefo, i biri i Dhimitri dhe i Donika, i datelindjes 22.04.1992, lindur në Korinthi, Greqi dhe banues në Fshat Maliq, Bashkia Maliq, arsim i mesëm, i martuar dhe pa fëmijë, përfaqësuar në gjykim nga avokat Ermir Skënderi, i zgjedhur me deklaram në seancë.

E PADITUR: Jurilda Stefo, e bija e Jorgo dhe Trëndafille, e datëlindjes 08.12.1998, lindur dhe banuese në Korçë, aktualisht me vendqendri në Tiranë në adresën: rruga “Haxhi Ymer Prizreni” Babru Shpat, Bashkia Kamzë, arsimit i lartë, e martuar dhe pa fëmijë.

OBJEKTI: Zgjidhje martesë

Baza ligjore: Neni 132 e vijues i K.Familjes, nenet 358, 368 të K.Pr.Civile

Në përfundim të gjykimit të zhvilluar në prani të paditesit, të përfaqësuesit të tij, si dhe në prani të të padituesit, është kërkuar:

Paditësi: Zgjidhjen e martesës ndërmjet palëve, pas zgjidhjes së martesës e paditura të marrë mbiemrin e vajzërisë.

E paditura: Zgjidhjen e martesës, marrjen prej saj të mbiemrit të vajzerise

Gjykata pasi shqyrtoi aktet dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V E R E N

Paditësi Kristo Stefo ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë kërkesëpadinë me objekt zgjidhjen e martesës me të padituesin Jurilda Stefo, si dhe rregullimin e pasojave pas zgjidhjes së saj, mbështetur në nenin 132 e vijues të Kodit të Familjes.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka kompetencën lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje referuar neneve 41 dhe 349 gërma "a" të K.Pr.Civile.

Po ashtu kjo gjykatë ka kompetencën tokësore referuar nenit 51 të K.Pr.Civile, pasi është gjykata e vendit ku bashkëshortët kanë pasur banimin e tyre të përbashkët të fundit, njëkohësisht ku ka banimin zyrtar e paditura.

Në seancën e pajtimit të datës 07.03.2022, të zhvilluar në prani të paditësit dhe të paditues, gjykata megjithë përpjekjet për pajtim, arriti në përfundimin se pajtimi mes bashkëshortëve dhe rikthimi në bashkëjetesë i tyre ishte i pamundur. Për këtë arsye, Gjykata vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se midis paditësit Kristo Stefo dhe të paditues Jurilda Stefo në datë 25.01.2021 është lidhur martesë ligjore provuar me çertifikatë martesë dt. 13.12.2021 dhe nga kjo lidhje nuk kanë lindur fëmijë, fakt i provuar me çertifikatën familjare dt.13.12.2021 lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Bashkia Korçë.

Gjate shqyrtimit gjyqësor paditësi Kristo Stefo dhe perfaqesuesi i tij deklaruan se: me të paditurën janë lidhur me shkuesi dhe kanë lidhur martesë në janar 2021. E paditura ka qene ne Greqi dhe kanë filluar bashkejetesen e cila zgjati rreth nje vit. Gjate kesaj periudhe ata kane kuptuar se karakteret e tyre ishin te ndryshem dhe kishin koncepte te ndryshme per jetesen, gje qe ka sjelle ftohjen e paleve dhe nje marredhenie jo shume te mire ndermjet tyre. Si rezultat i kesaj situate, palet me mirekuptim kane vendosur t i japin fund lidhjes se tyre dhe prej me teper se 2 muaj ata jane te vecuar dhe nuk kane me kontakte. Paditësi vazhdon te jetoje ne Greqi me familjen sikurse edhe me pare, kurse e paditura jeton ne Shqiperi.

Sipas paditesit, nuk ka asnje mundësi për pajtim me të paditurën, ndaj ai kërkon zgjidhjen e kësaj martesë. Kurse në lidhje me mbiemrin, paditësi u shpreh qe e paditura të merrte mbiemrin qe ka pasur para martesë "Çela".

E paditura Jurilda Stefo gjate gjykimit deklaroi se: martesë ndermjet tyre ka qene me njohjen e te afermve dhe kane filluar bashkejetese. Sipas te paditues, shkak per prishjen e kesaj martesë dhe vecimin e paleve ka qene fakti se ata kane pasur natyra te ndryshme dhe nuk merreshin vesh me njeri-tjetrin per probleme te ndryshme. Ndodhur në të tilla rrethana, e paditura deklaroi se eshte kthyer ne Shqiperi dhe vazhdon te jetoje me familjen, duke shkeputur me paditesin cdo lloj kontakti qe prej me shume se 2 muajsh. Edhe e paditura u shpreh se ishte i pamundur pajtimi dhe se martesë duhet te zgjidhej. Kurse në lidhje me mbiemrin, ajo kerkoi të merrte mbiemrin qe ka pasur para martesë "Çela".

Gjykata mban parasysh kriteret e nenit 132 të Kodit të Familjes në të cilin përcaktohet se "Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës kur për shkak të grindjeve të vazhdueshme, keqtrajtimit...jetesa e përbashkët bëhet e pamundur dhe martesë ka humbur qëllimin e saj".

Mbështetur në përcaktimet e mësipërme, çdonjërit prej bashkëshortëve i lind e drejta të kërkojë zgjidhjen e martesës dhe një nga shkaqet për të cilin secili bashkëshort mund të kërkojë zgjidhjen e martesës janë mosmarrëveshjet midis tyre të cilat për shkak të karakterit të tyre të vazhdueshëm e kanë bërë jetesën e përbashkët midis bashkëshortëve të pamundur dhe martesë e ka humbur qëllimin e saj në funksion të mirëqënies materiale dhe emocionale të bashkëshortëve. Gjykata duke vlerësuar pohimet e palëve dhe provat e administruara në seancë gjyqësore, konstaton faktin se konfliktet midis palëve ndër-gjyqëse, si dhe pamundësia për të gjetur një zgjidhje në lidhje me problemet që kanë pasur, kanë sjellë si pasojë mosfunksionimin e martesës ligjore që duhet të karakterizojë një marrëdhënie martesore normale. Duhet theksuar fakti se të dy bashkëshortet prej disa muajsh jetojnë të veçuara, e paditura është larguar nga banesa bashkëshortore ku palet kanë jetuar ne Greqi, kurse paditësi jeton edhe aktualisht në shtetin grek, ndaj dhe ndodhemi para ndërprerjes faktike të jetesës së përbashkët midis palëve.

Në këto kushte Gjykata duhet të vendosë zgjidhjen e martesës ligjore midis paditësit Kristo Stefo dhe të paditues Jurilda Stefo.

Në lidhje me pasojat e zgjidhjes së martesës, gjykata ka detyrim të shprehet në lidhje me këto pasoja midis bashkëshorteve, duke marrë parasysh kriteret e nenit 146 të Kodit të Familjes, në të cilin përcaktohet se *“Bashkeshorti që me lidhjen e martesës ka ndryshuar mbiemrin e tij, pas zgjidhjes së martesës merr mbiemrin që ka pasur përpara lidhjes së martesës. Gjykata, me kërkesën e njërit bashkëshort dhe kur është në interes të tij ose të fëmijëve, mund të lejojë që ai të mbajë mbiemrin që ka marrë me lidhjen e martesës”*.

Nga ana e te paditues Jurilda Stefo u kërkua që ajo të marrë mbiemrin qe ka pasur para martese “Çela”.

Se fundi, në aplikim të nenit 143 të Kodit te Familjes dhe të nenit 31 të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “Per Gjendjen Civile”. Gjykata ka detyrimin që brenda 15 ditëve nga dita që vendimi merr formë të prerë të dërgojë për rregjistrim një kopje të tij ne Zyrën e Gjendjes Civile përkatëse, në rastin në gjykim në Zyren e Gjendjes Civile Bashkia Korçë.

Përsa i përket shpenzimeve gjyqësore, të cilat përbëhen nga taksa mbi aktet në shumën 3.000 leke, të parapaguara nga paditësi, në mbeshtetje te nenit 102 dhe 106 të Kodit të Procedures Civile, gjykata cmon se duhet t'i mbeten në ngarkim paditësit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar ne nenin 132 te Kodit te Familjes
dhe nenet 126 dhe 306-310 te K.Pr.Civile



VENDOSI

1. Pranimin e kerkeseпадise.
2. Zgjidhjen e martesës ligjore te lidhur ne date 25.01.2021 midis paditesit Kristo Stefo dhe te paditues Jurilda Stefo.
3. E paditura Jurilda pas zgjidhjes se martesës merr mbiemrin qe ka pasur para martese “Çela”.
4. Nje kopje e ketij vendimi te dergohet ne Zyren e Gjendjes Civile Maliq, pas marrjes forme te prerë.
5. Shpenzimet gjyqësore ne masen 3000 leke mbeten ne ngarkim te paditesit sikurse jane bere.
6. Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Korçë, brenda 15 diteve nga e nesermja e njoftimit te vendimit te arsyetuar.

U shpall në Korçë, sot në datë 07.03.2022 ora 11:29

SEKRETARE
ADRIANA FERRO

GJYQTARE
LULJETA KOLE



28 MAR 2022

